Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

PRISHTINA

KRYETARI I KRYEQYTETIT
14-020/04-105164/26, më 14 JUL 2026

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L - 087, të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ANËTARES NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE "KU'ZINA" SH.A.

1. **Znj. Besa Prestreshi**, caktohet anëtare në komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale të Komunës së Prishtinës "Ku'zina" SH.A.

2. Anëtarja e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, së bashku me dy anëtarët të cilët i emëron Kuvendi i Komunës, e përbëjnë komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Ku'zina" SH.A.

3. Anëtarja e komisionit komunal të aksionarëve, e caktuar me këtë vendim, ka të drejtë të veprojë në emër të Kryetarit të Kryeqytetit.

4. Veprimet e anëtares së komisionit komunal të aksionarëve duhet të jenë në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:
- **Anëtares;**
- **Qendrës për shërbim me qytetarë;**
- **Në dosje.**

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

REPUBLIKA E KOSOVËS KABINETI I KRYETARIT KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINA PRIŠTINA REPUBLIKA KOSOVA